

Raporti i plotë i Treshes së Grupit të Kontaktit

RAPORTI I PLOTË I TRESHES: ISHINGER, UIZNER, KHARÇENKO (BE, SHBA, RUSI) PËR KOSOVËN I DORËZUAR NË KS TË OKB-së (DHJETOR 2007)



~~~~~

### Përmbledhje

1. Ne, Trojka e përfaqësuesve nga Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara dhe Rusia, i kemi kaluar katër muajt e fundit duke zhvilluar negociata mes Beogradit dhe Prishtinës mbi statusin e ardhshëm të Kosovës. Qëllimi ynë ka qenë të ndihmojmë një marrëveshje mes palëve. Negociatat janë zhvilluar brenda kornizës së Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999) dhe “Parimeve udhëzuese” të Grupit të Kontaktit (bf anekset 1 dhe 2). Gjatë punës sonë, palët kanë diskutuar një sërë opsionesh, si pavarësia e plotë, pavarësia e mbikëqyrur, ndarja territoriale, autonomia substanciale, rregullimet konfederale, madje edhe një “marrëveshje për të mos u marrë vesh” e qetë për statusin.

2. Trojka ka qenë në gjendje të ndihmojë diskutime të nivelit të lartë, intensive dhe të pavarura mes Beogradit dhe Prishtinës. Megjithatë, palët nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë marrëveshje për statusin përfundimtar të Kosovës. Asnjëra palë nuk ka qenë e gatshme të heqë dorë nga pozicioni i vet për çështjen fundamentale të sovranitetit të Kosovës. Kjo është për të ardhur keq, meqë zgjidhja e negociuar është në interesin më të mirë të të dyja palëve.

## Sfond

3. Një proces politik për të përcaktuar statusin e ardhshëm të Kosovës, çështja e fundit e madhe që lidhet me kolapsin e Jugosllavisë, është zhvilluar për më shumë se dy vjet. Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara e ka emëruar Martti Ahtisaarin si të dërguar të tij të posaçëm në nëntor të vitit 2005 për ta marrë përsipër procesin e statusit të ardhshëm, siç parasheh Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999). Pas pesëmbëdhjetë muajsh të negociatave të përkrahura nga OKB-ja, presidenti Ahtisaari ka përgatitur një Propozim Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i cili ka përfshirë masa për mbrojtjen e komuniteteve joshqiptare të Kosovës dhe një rekomandim që Kosova duhet të bëhet e pavarur duke iu nënshtruar një periudhe të mbikëqyrjes ndërkombëtare. Prishtina e ka pranuar zgjidhjen e Ahtisaarit në tërësinë e saj. Beogradi e ka refuzuar atë.

4. Pas një periudhe të diskutimeve në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, Grupi i Kontaktit (Franca, Gjermania, Italia, Rusia, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara) ka propozuar që një “Trojkë” e zyrtarëve nga BE-ja, Shtetet e Bashkuara dhe Rusia të ndërmarrin edhe një periudhë tjetër të negociatave me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje të negociuar. Më 1 gusht 2007, sekretari i përgjithshëm i OKB-së e ka mirëpritur këtë iniciativë, e ka rikonfirmuar besimin e tij se status quoja është e paqëndrueshme dhe kërkoi një raport nga Grupi i Kontaktit për këto përpjekje deri më 10 dhjetor 2007. Zyra e të dërguarit të posaçëm të sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës (UNOSEK) do të ndërliqej me këtë proces duke qenë e gatshme që të sigurojë informata dhe qartësime sipas kërkesës (bf aneksi 3).

## Misioni i Trojkës

5. Me caktimin tonë si përfaqësues të Trojkës, ne jemi zotuar që “të mos e lëmë asnjë gur pa e lëvizur” në kërkim të një zgjidhjeje reciprokisht të pranueshme. Në ndjekje të këtij qëllimi, ne ua kemi shpjeguar palëve parimet që do ta udhëheqin punën tonë. Së pari, ne ripohuam se Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999) dhe “Parimet udhëzuese” të Grupit të Kontaktit, nëntor 2005, do të vazhdojnë të jenë korniza jonë operuese. E dyta, ne kemi treguar se derisa zgjidhja e Ahtisaarit ishte ende në tavolinë, ne do të kishim qenë të përgatitur që ta pranojmë çfarëdo marrëveshjeje që palët do të

kishin mundur ta arrinin. Të dyja palëve vazhdimisht u është rikujtuar se ata janë përgjegjës për sukses ose dështim të procesit.

6. Ne po ashtu kemi shpjeguar se Trojka nuk e ka pasur për qëllim që të imponojë një zgjidhje. Në vend të kësaj, të dy palët e kanë mbajtur barrën për ta bindur palën tjetër për të mirat e pozicionit të vet. Edhe pse roli ynë primar ka qenë që të ndihmojmë dialogun e drejtpërdrejtë, ne po ashtu jemi përpjekur që të marrim një rol më aktiv në identifikimin e fushave për kompromis të mundshëm.

Orari

7. Gjatë katër muajve të mandatit tonë, kemi pasur një orar të ngjeshur takimesh me palët (b.f. aneksi 4). Ky orar ka qenë i përmbledhur në dhjetë seanca, gjashtë nga të cilat kanë përfshirë dialog të drejtpërdrejtë, përfshirë edhe atë përfundimtarin, një konferencë treditore në Baden të Austrisë, si dhe dy udhëtime në rajon. Gjatë procesit, Beogradi ka qenë i përfaqësuar nga presidenti Boris Tadiq, kryeministri Vojislav Koshtunica, ministri i Jashtëm Vuk Jeremiq dhe ministri për Kosovën, Slobodan Samarxhiq. Prishtina është përfaqësuar nga Ekipi i Unitetit i përbërë nga kryetari Fatmir Sejdiu, kryeministri Agim Çeku, kryetari i Kuvendit Kolë Berisha, Hashim Thaç dhe Veton Surroi. Trojka e ka përshëndetur faktin se të dyja delegacionet janë përfaqësuar në nivelin më të lartë të mundshëm, duke nënvizuar kështu rëndësinë që i kanë dhënë procesit. Pos seancave të përbashkëta, kemi aranzhuar edhe takime të ndara me palët, në mënyrë që të konsultohemi me to veç e veç. Seancat tona kanë qenë të gjata dhe shumë herë të mundimshme, ndërsa jemi përballur me mosbesimin e ndërsjellë dhe ndjenjën e kujtimeve të konfliktit të viteve nëntëdhjetë. Grupi i Kontaktit e ka mbështetur punën tonë dhe ministrat e jashtëm të tij i kanë ftuar palët që të hyjnë në bisedime me “kreativitet, guxim dhe frymë të kompromisit” (b.f. aneksi 5). Njëherësh, kemi synuar dhe kemi marrë premtimet nga palët se asnjëra nuk do të nxisë akte ose deklaratat provokuese gjatë procesit (b.f. anekset 6 dhe 7).

8. Kur po e nisnim punën tonë, i kemi shqyrtuar qëndrimet e forta të të dyja palëve. Prishtina e ka rideklaruar preferencën e saj për pavarësi të mbikëqyrur të Kosovës dhe e ka rikonfirmuar pranimin e saj të propozimit të Ahtisaarit. Beogradi e ka refuzuar propozimin e Ahtisaarit dhe e ka rideklaruar qëndrimin e saj për autonomi të Kosovës në kuadër të Serbisë. Si rezultat i kësaj, propozimi i

Ahtisaarit nuk është diskutuar fare, qoftë edhe për modifikimet e tij. Të dyja palët kanë ofruar argumente historike, funksionale, ligjore dhe praktike për të mbështetur rezultatet e tyre të preferuara. Beogradi e ka elaboruar modelin e vet për autonomi substanciale për të shtuar pushtetin e Kosovës për autonomi dhe për t'i zvogëluar ato që atij i rezervohen. Ai ka vlerësuar se nuk do të ketë kthim të gjendjes së para marsit të vitit 1999. Prishtina ka paraqitur një projekt të "Traktatit të Miqësisë dhe të Bashkëpunimit" që përshkruan se si Kosova dhe Serbia, si shtete të pavarura, do të duhej të bashkëpunonin lidhur me çështje që u përkasin të dyjave, të themelonin organe të përbashkëta, të përparonin zotimet e tyre për multietnicitetet dhe të mbështesin njëra-tjetrën në aspiratat evropatlantike.

9. Me gjithë thirrjet tona të vazhdueshme për ide të reja dhe frymë të kompromisit, asnjëra palë nuk ka mundur ta bindte tjetrën. Të mbështetur nga Deklarata Ministrore e Grupit të Kontaktit e 27 shtatorit (b.f. aneksi 4), kemi ndërmarrë një qasje më aktive. Kemi zhvilluar vlerësimin tonë në një formë me 14 pika (aneksi 8). Palët janë përgjigjur ndaj këtyre pikave, pa i pranuar ato plotësisht.

10. Nën udhëheqjen tonë, palët i kanë shqyrtuar rezultatet që përfshinin një vister që nga pavarësia deri te autonomia, si dhe modelet alternative si aranzhimet konfederale dhe madje një model të mbështetur në "marrëveshjen për të mos u marrë vesh", sipas së cilës palët do të duhej të shprehnin qëndrimet e tyre, por do të kryenin marrëveshje praktike të dizajnuara për të ndihmuar bashkëpunimin dhe konsultimet e ndërsjella. Modelet e tjera ndërkombëtare, si ai i Hong-Kongut, Ishujve Åland dhe i Shteteve të Pavarura të Komonueltit janë diskutuar. Ndonëse është përmendur, nuk kemi trajtuar opsionin e ndarjes territoriale që është konsideruar e papranueshme nga të dyja palët dhe nga Grupi i Kontaktit. Asnjë nga këto modele nuk doli të jetë bazë adekuate për kompromis. I kemi përmbyllur negociatat e drejtpërdrejta me palët në një konferencë të nivelit të lartë në Baden të Austrisë gjatë periudhës 26 – 28 nëntor, ku edhe një herë i kemi ftuar palët që të gjejnë një mënyrë për ta zgjidhur nyjën.

Përfundimi

11. Të dyja palët kanë qenë të angazhuara plotësisht gjatë tërë negociatave. Pas 129 ditësh negociata intensive, megjithatë, palët nuk kanë qenë të gjendje të arrijnë një marrëveshje mbi statusin e

Kosovës. Asnjëra palë nuk ka qenë e gatshme të lëshojë pe për çështjen themelore të sovranitetit.

12. Sidoqoftë, me gjithë këtë dallim fundamental mbi statusin, të cilin Trojka e ka mundur ta afrojë, ne besojmë se ky proces i ka shërbyer një qëllimi të dobishëm. Ne u dhamë palëve mundësinë për të gjetur një zgjidhje për dallimet e tyre. Nën ombrellën tonë, palët u përfshinë në dialogun direkt më të gjatë dhe intensiv të nivelit të lartë që nga përfundimi i armiqësitë në Kosovë, më 1999. Gjatë këtij procesi, palët zbuluan fushat ku interesat e tyre përputheshin. Palët, po ashtu u pajtuan për nevojën e promovimit dhe mbrojtjes së shoqërive shumetnike dhe të adresimit të çështjeve të vështira që pengojnë pajtimin, posaçërisht fatin e personave të zhdukur dhe kthimin e personave të zhvendosur. Mbase më e rëndësishmja, Beogradi dhe Prishtina kanë riafirmuar se perspektiva evropiane është boshti i marrëdhënieve të tyre evropiane, ndërsa të dyja palët e kanë ritheksuar dëshirën e tyre për të kërkuar një të ardhme nën kulmin e përbashkët të Bashkimit Evropian.

13. Derisa dallimet mes palëve mbesin të pandryshuara, Trojka, megjithatë, ka qenë në gjendje të nxjerrë përkushtime të rëndësishme nga palët. Në veçanti, të dyja palët janë zotuar se do të përmbahen nga veprimet që do të mund ta rrezikojnë situatën e sigurisë në Kosovë apo diku tjetër dhe të mos e përdorin dhunën, kërcënimet apo frikësimin (bf aneksi 9). Ata i bënë këto zotime pa paragjykuar pozicionet e tyre për status. Të dyja palëve duhet t'u rikujtohet se dështimi i tyre për t'iu përmbajtur këtyre zotimeve do të ndikojë në arritjen e së ardhmes së tyre evropiane që e synojnë të dyja ato.

14. Ne theksojmë se Kosova dhe Serbia do të vazhdojnë të jenë të lidhura së bashku për shkak të natyrës së posaçme të marrëdhënieve të tyre, posaçërisht në dimensionin historik, njerëzor, gjeografik, ekonomik dhe kulturor. Siç është thënë nga ministrat e Grupit të Kontaktit në takimin e tyre në New York, më 27 shtator, zgjidhja e statusit të Kosovës është thelbësore për stabilitetin dhe sigurinë e Ballkanit Perëndimor dhe Evropës në tërësi. Ne besojmë se mbajtja e paqes në rajon dhe shmangia nga dhuna është e një rëndësie të madhe dhe për këtë arsye kërkojmë nga palët që të qëndrojnë pranë zotimeve të tyre. Ne, për më shumë, besojmë fuqishëm se zgjidhja e statusit të Kosovës do të kontribuonte në përmbushjen e aspiratave evropiane të të dyja palëve.

## **Anekset:**

### **A) Dokumente**

- 1) Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999)
- 2) “Parimet udhëzuese” të Grupit të Kontaktit (nëntor 2005)

### **B) Dokumente të Trojkës**

- 3) Deklarata e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së për periudhën e re të angazhimeve në Kosovë (1 gusht 2007)
- 4) Ngjarjet e Treshes
- 5) Deklarata për Kosovën e ministrave të Grupit të Kontaktit (27 shtator 2007)
- 6) Dokumenti jozyrtar i Vjenës (30 Gusht 2007)
- 7) Deklarata e New York-ut (28 Shtator)
- 8) Vlerësimet e Treshes për negociatat: Konkluzionet parimore
- 9) Deklarata për shtyp e Trojkës (Baden, 28 nëntor 2007)

### **Aneksi 1: Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999) Këshilli i Sigurimit**

Duke i pasur parasysh përcaktimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe përgjegjësinë primare të Këshillit të Sigurimit për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare;  
Duke rikujtuar rezolutat 1160 (1998) të 31 marsit 1998, 1199 (1998) të 23 shtatorit 1998, 1203 (1998) të 24 tetorit 1998, dhe 1239 (1999) të 14 majit 1999;

Duke shprehur keqardhje për mospajtueshmëri të plotë ndaj kërkesave të këtyre rezolutave, të përcaktuara për zgjidhjen e situatës së nderë humanitare në Kosovë, Republika Federative e Jugosllavisë, dhe garantimin e kthimit të lirë dhe të sigurt të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre;

Duke dënuar të gjitha aktet e dhunës kundër popullatës së Kosovës dhe aktet terroriste të cilësdo palë;

Duke rikujtuar deklaratën e bërë nga sekretari i përgjithshëm, më 9 prill 1999, në të cilën shpreh brengosjen e tij ndaj tragjedisë humanitare në Kosovë;

Duke riafirmuar të drejtën e të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur për t'u kthyer në shtëpitë e tyre të sigurt;

Duke rikujtuar juridiksionin dhe mandatin e Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë;

Duke mirëpritur parimet e përgjithshme të zgjidhjes politike të çështjes së Kosovës, të miratuar më 6 maj 1999 (S/1999/516, aneksi 1

i kësaj rezolutive) dhe duke mirëpritur gjithashtu edhe pranimin nga Republika Federative e Jugosllavisë të këtyre parimeve të vëna më parë në pikat 1 deri në 9 të dokumentit të prezantuar në Beograd më 2 qershor 1999 (S/1999/649, aneksi 2 i kësaj rezolutive), dhe pajtueshmërinë e Republikës Federative të Jugosllavisë ndaj këtij dokumenti;

Duke riafirmuar detyrimin e të gjitha shteteve anëtare ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe të shteteve të tjera në rajon, të theksuara në Aktin Final të Helsinkit dhe aneksin 2;

Duke riafirmuar thirrjen në rezolutat e mëparshme për autonomi themelore dhe vetadministrim për Kosovën;

Duke përcaktuar atë se situata në rajon vazhdon ta kërcënojë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare;

Të përcaktuar për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e personelit ndërkombëtar, si dhe implementimin e obligimeve nga të gjithë të interesuarit, që dalin nga Rezoluta e tanishme, dhe duke vepruar për këto qëllime sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

1. Vendos që zgjidhja politike e krizës së Kosovës duhet të bazohet në parimet e përgjithshme të aneksit 1 dhe më tej të elaboruara në parimet dhe elementet e tjera të kërkuara në aneksin 2;

2. Mirëpret pranueshmërinë nga RFJ-ja të këtyre parimeve dhe elementeve të kërkuara, të referuara në paragrafin 1, dhe kërkon bashkëpunim të plotë të RFJ-së në implementimin e shpejtë të tyre;

3. Kërkon veçanërisht që Republika Federative e Jugosllavisë të vërë një përfundim të menjëhershëm dhe të verifikueshëm të dhunës dhe represionit në Kosovë dhe të fillojë që ta kompletojë në faza tërheqjen e verifikueshme të të gjitha forcave ushtarake, policore dhe paramilitare nga Kosova, duke u bazuar në planin e shpejtë, me të cilin vendosja e prezencës së sigurisë ndërkombëtare në Kosovë do të jetë e sinkronizuar;

4. Konfirmon se pas tërheqjes, sipas marrëveshjes, një numër i ushtarakëve dhe policëve jugosllavë dhe serbë do të lejohen të kthehen në Kosovë për t'i kryer funksionet e veta bazuar në aneksin 2;

5. Vendos mbi zbarkimin e trupave në Kosovë, nën udhëheqjen e Kombeve të Bashkuara, të prezencës ndërkombëtare civile dhe të sigurisë, me pajisje adekuate dhe personel sipas nevojës, dhe mirëpret marrëveshjen e RFJ-së ndaj këtyre prezencave;

6. Kërkon nga sekretari i përgjithshëm që të emërojë, në konsultim me Këshillin e Sigurimit, një përfaqësues special për të kontrolluar implementimin e misionit civil ndërkombëtar, ndërsa më tej kërkon nga sekretari i përgjithshëm ta këshilloj përfaqësuesin special që të bashkëpunojë ngushtë me misionin e sigurisë ndërkombëtare për të garantuar se që të dy misionet veprojnë në drejtim të qëllimeve të njëjta dhe se mbështesin njëra-tjetrën;

7. Autorizon shtetet anëtare dhe organizatat relevante ndërkombëtare që të krijojnë praninë e sigurisë ndërkombëtare në Kosovë, siç theksohet në pikën 4 të aneksit 2, me të gjitha mjetet e nevojshme për t'i përmbushur përgjegjësitë e tyre që janë në paragrafin 9 në vijim;

8. Afirmon nevojën për një vendosje të shpejtë të një pranie efektive civile ndërkombëtar dhe ushtarake në Kosovë, dhe kërkon që palët të bashkëpunojnë plotësisht në vendosjen e tyre;

9. Vendos që përgjegjësi e pranisë së sigurisë ndërkombëtare, e cila do të vendoset dhe do të veprojë në Kosovë, do të jetë;

a. Frenimi i luftimeve të rifilluara, duke mbetur aty ku është e domosdoshme për të detyruar armëpushimin, dhe për të garantuar tërheqjen dhe parandalimin e hyrjes në Kosovë të ushtrisë, policisë dhe forcave paramilitare të RFJ-së, përveç siç është paraparë në pikën 6 të aneksit 2;

b. Demilitarizimi i UÇK-së dhe grupeve të tjera të armatosura shqiptare, siç kërkohet në vazhdim në paragrafin 15;

c. Krijimi i një ambienti të sigurt, ku refugjatët dhe personat e zhvendosur mund të kthehen në shtëpi të sigurt, që prania ndërkombëtare civile të mund të veprojnë, që të krijohet administrata transicionale, dhe që ndihmat humanitare të mund të shpërndahen;

d. Garantimi i sigurisë publike dhe ligjit, derisa prania ndërkombëtare civile të mund të marrë përgjegjësinë për këtë çështje;

e. Mbikëqyrja, siç është paraparë, e çminimit, derisa prezenca ndërkombëtare civile të mund të marrë përgjegjësinë për këtë çështje;

f. Mbështetja, siç është paraparë, dhe bashkëpunimi i ngushtë me punën e prezencës ndërkombëtare civile;

g. Ushtrimi i mbikëqyrjes së kufijve sipas kërkesës;

h. Sigurimi i mbrojtjes dhe lirisë së lëvizjes për të gjithë, prezenca civile ndërkombëtare dhe organizatat e tjera ndërkombëtare;



10. Autorizohet sekretari i përgjithshëm, me ndihmën e organizatave relevante ndërkombëtare, të organizojë një prezencë civile ndërkombëtare në Kosovë në mënyrë që të sigurojë një administratë të përkohshme për Kosovën nën udhëheqjen e së cilës populli i Kosovës do të gëzojë autonomi substanciale në kuadër të RFJ-së, dhe do të sigurojë administratë kalimtare derisa të formohen institucionet demokratike vetëqeverisëse për të krijuar kushtet për një jetë normale dhe paqësore për të gjithë banorët e Kosovës;

11. Vendos që përgjegjësitë kryesore të prezencës civile ndërkombëtare do të përfshijnë:

Përkrahjen e krijimit të kushteve për gjetjen e zgjidhjes finale, të autonomisë substanciale dhe vetëqeverisjes në Kosovë, duke u mbështetur plotësisht në aneksin 2 dhe në Marrëveshjen e Rambujesë (S/1999/648)

Kryerja e funksioneve themelore civile administrative derisa ajo të kërkohet;

Organizimi dhe mbikëqyrja e zhvillimit të institucioneve të përkohshme për demokratizim dhe vetëqeverisje autonome, duke gjetur zgjidhjen politike, duke përfshirë këtu edhe mbajtjen e zgjedhjeve;

Bartja e përgjegjësisë në institucionet e krijuara, në ndërkohë që mbikëqyret dhe mbështetet konsolidimi i institucioneve të përkohshme lokale dhe aktivitetet e tjera për ndërtimin e paqes;

Ndërmjetësimi në procesin politik që ka për qëllim përcaktimin e statusit të Kosovës në të ardhmen, duke marrë parasysh Marrëveshjen e Rambujesë (S/1999/648);

Në fazën e fundit, mbikëqyrja e bartjes së autoritetit nga institucionet e përkohshme të Kosovës në institucionet e krijuara me zgjedhje politike;

Mbështetja në rindërtimin e infrastrukturës kryesore dhe rindërtimet e tjera ekonomike;

Mbështetje humanitare dhe ndihmë për lehtësim në fatkeqësi, në koordinim me organizatat humanitare ndërkombëtare;

Mbajtja e ligjeve dhe rregullave civile, duke përfshirë edhe krijimin e një force policore lokale në ndërkohë që do të vendosej një forcë policore ndërkombëtare e cila do të shërbente në Kosovë;

Mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut;

Garantimin e sigurisë dhe kthimi i papenguar i refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë;

12. Theksimi i nevojës për koordinimin e veprimtarive humanitare, ndërsa për RFJ-në që të lejojë qasje të papenguar të organizatave humanitare në Kosovë dhe të bashkëpunojë me këto organizata për të garantuar shpërndarjen e shpejtë dhe efektive të ndihmave ndërkombëtare;

13. Inkurajon të gjitha shtetet anëtare dhe organizatat ndërkombëtare për të kontribuar në rindërtimin ekonomik dhe social dhe në kthimin e sigurt të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, dhe thekson, në këtë kontekst, rëndësinë e mbajtjes së konferencës ndërkombëtare të donatorëve, veçanërisht për propozimet në paragrafin 11 (g), dhe atë sa më shpejt që të jetë e mundshme;

14. Kërkon bashkëpunim të plotë nga të gjithë të lartpërmendurit, përfshirë këtu edhe prezencën e sigurisë ndërkombëtare së bashku me Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës për ish-Jugosllavinë;

15. Kërkon nga UÇK-ja dhe grupet e tjera të armatosura shqiptare që të ndalojnë urgjentisht të gjitha aksionet sulmuese dhe t'u përmbahen kërkesave për demilitarizim të nxjerra nga kryesuesi i prezencës së sigurisë ndërkombëtare në konsultim me të dërguarin special të sekretarit të përgjithshëm;

16. Vendos që ndalesat e shtruar në paragrafin 8 të Rezolutës 1160 (1998) nuk do të aplikohen për armët dhe materialin e ngjashëm në përdorim të prezencës ndërkombëtare civile dhe ushtarake;

17. Mirëpret punën e Unionit Evropian dhe organizatave të tjera ndërkombëtare që të zhvillojnë qasje të gjithanshme ndaj zhvillimit ekonomik dhe stabilizimit të rajonit në të cilin ka ndikuar kriza në Kosovë, duke përfshirë edhe implementimin e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore, me pjesëmarrje të gjerë ndërkombëtare në promovimin e mëtejme të demokracisë, prosperitetit ekonomik, stabilitetit dhe bashkëpunimit në rajon;

18. Kërkon që të gjitha shtetet në rajon të bashkëpunojnë plotësisht në implementim e kësaj rezolute në të gjitha aspektet;

19. Vendos që prezenca ndërkombëtare civile dhe ushtarake fillimisht të vendoset për një periudhë prej 12 muajsh, me mundësinë që të vazhdojë qëndrimin përderisa Këshilli i Sigurimit të mos vendos në tjetër mënyrë;

20. Kërkon nga sekretari i përgjithshëm t'i raportojë Këshillit në intervale të rregullta kohore mbi implementimin e kësaj rezolute, përfshirë këtu edhe raportet nga udhëheqja e prezencës civile dhe ushtarake, ndërkohë që raportet e para duhet dorëzuar 30 ditë pas miratimit të kësaj rezolute;

21. Vendos që të mbesë aktiv në zotimet për këtë çështje,

## **Aneksi 1**

Deklarata e kryesuesit mbi konkluzat e takimit të ministrave të G-8-s të mbajtur në Petersberg Centre, më 6 maj 1999

Ministrat e jashtëm të G-8-s miratuan këto parime të përgjithshme mbi zgjidhjen politike të krizës së Kosovës:

- Përfundimin e menjëhershëm dhe të verifikueshëm të represionit në Kosovë;
- Tërheqjen e forcave ushtarake, policore dhe paramilitare nga Kosova;
- Vendosjen e trupave ndërkombëtare civile dhe ushtarake, me miratimin e Kombeve të Bashkuara, me aftësi që garantojnë përmbushjen e objektivave të përbashkëta;
- Krijimin e një administrate të përkohshme për Kosovën, e cila do të vendoset nga Këshilli i Sigurimit të KB-së për të garantuar kushtet për një jetë normale dhe paqësore për të gjithë banorët e Kosovës;
- Kthimin e sigurt dhe të lirshëm të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur, si dhe hyrjen e papenguar të organizatave humanitare ndërkombëtare në Kosovë;
- Procesi politik i cili çon drejt krijimit të një kornize të përkohshme politike, marrëveshje kjo që parasheh vetëqeverisje substanciale për Kosovën, duke marrë parasysh në tërësi Marrëveshjen e Rambujesë dhe parimet e sovranitetit dhe integritetit territorial të RFJ-së dhe të vendeve të tjera përreth, si dhe demilitarizimin e UÇK-së;
- Qasja e gjithanshme ndaj zhvillimit ekonomik dhe stabilizimit të rajonit të krizës;

## **Aneksi 2**

Marrëveshja duhet të arrihet në bazë të parimeve të mëposhtme për të lëvizur drejt rezolutës së krizës së Kosovës:

1. Një fund i menjëhershëm dhe i verifikueshëm i dhunës dhe represionit në Kosovë.

2. Një tërheqje e verifikueshme e të gjitha forcave ushtarake, policore dhe paraushtarake nga Kosova, sipas një orari të shpejtë.

3. Vendosja e një prezence ndërkombëtare civile dhe e sigurisë në Kosovë nën patronazhin e OKB-së, e cila do të veprojë siç mund të vendoset sipas Kreut VII të Kartës së OKB-së, me aftësi për të garantuar arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

4. Prania ndërkombëtare e sigurisë, me një pjesëmarrje substanciale të NATO-s, duhet të vendoset nën një komandë dhe kontroll të përbashkët, dhe të jetë e autorizuar për të vendosur një ambient të sigurt për të gjithë njerëzit në Kosovë, si dhe për të mundësuar kthimin e sigurt në shtëpitë e tyre për të gjithë të zhvendosurit dhe refugjatët.

5. Vendosja e një administrate të përkohshme për Kosovën, si pjesë e pranisë civile ndërkombëtare, nën të cilën populli i Kosovës do të gëzojë një autonomi substanciale brenda RFJ-së, e cila do të vendoset nga KS i KB. Administrata e përkohshme do të ofrojë një administrim kalimtar, duke vendosur dhe vlerësuar një zhvillim të institucioneve të përkohshme, demokratike vetëqeverisëse, për të siguruar kushtet për një jetë paqësore dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës.

6. Pas tërheqjes, një numër i pranuar i personelit jugosllav dhe serb do të lejohet të kthehet në Kosovë, për të kryer funksionet e mëposhtme:

- Kontaktin me misionin ndërkombëtar civil dhe me praninë ndërkombëtare të sigurisë;
- Shënimin dhe pastrimin e fushave të minuara;
- Mbajtjen e një pranie në trashëgimin serbe;
- Mbajtjen e një pranie në vendkalimet kufitare kryesore;
- Kthim të sigurt dhe të lirë për të gjithë refugjatët dhe të zhvendosurit nën mbikëqyrjen e Zyrës së UNHCR-së dhe qasje të papenguar për të gjitha organizata humanitare në Kosovë.

8. Një proces politik drejt vendosjes së një kornize për një marrëveshje politike të përkohshme, e cila do t'i ofrojë Kosovës një vetëqeverisje substanciale, e cila do të marrë parasysh Marrëveshjen e Rambujesë dhe parimet e sovranitetit territorial të RFJ-së dhe të shteteve të tjera në rajon, si dhe demilitarizimin e UÇK-së, negociatat ndërmjet palëve për një zgjidhje nuk duhet të vonojnë, apo të pengojnë vendosjen e institucioneve demokratike vetëqeverisëse.

9. Një qasje e gjithanshme zhvillimit ekonomik dhe stabilitetit të rajonit, kjo do të përfshijë implementimin e një pakti të stabiliteti për Evropën Juglindore me një pjesëmarrje të gjerë ndërkombëtare, për të përparuar demokracinë, prosperitetin ekonomik, stabilitetin dhe bashkëpunimin rajonal.

10. Suspendimi i aktiviteteve ushtarake do të kërkojë pranimin e parimeve të vendosura më lart, si shtesë parimeve të vendosura më lart, si dhe elementeve të kërkuara, të identifikuar më herët, të cilat janë të specifikuar në fusnotën 1. Marrëveshja tekniko-ushtarake, e cila do të arrihet shpejt, në mes të tjerash do të specifikojë modalitetet shtesë, duke përfshirë edhe rolin dhe funksionin e forcave jugosllavo-serbe në Kosovë.

## **Tërheqja**

- Procedura për tërheqje, duke përfshirë një skemë të detajuar nëpër faza dhe përcaktimin e vijës përtej së cilës forcat serbe duhet të tërhiqen;

Personeli që do të kthehet

- Pajisja shoqëruese e personelit që do të kthehet;
- Kushtet në lidhje me përgjegjësitë e funksionit të tyre;
- Orari i kthimit të tyre;
- Përcaktimi i zonave gjeografike ku do të operojnë ata;
- Rregullat me të cilat do të përcaktohen marrëdhëniet në mes tyre dhe pranisë ndërkombëtare të sigurisë dhe misionit civil ndërkombëtar

Aneksi 2: “Parimet udhëheqëse” të Grupit të Kontaktit (nëntor 2005)

Grupi i Kontaktit ka shqyrtuar letrën e sekretarit të përgjithshëm dhe raportin e ambasadorit Kai Eide mbi shqyrtimin gjithëpërfshirës të gjendjes në Kosovë, që i janë paraqitur Këshillit të Sigurimit më 7 tetor 2005.

Grupi i Kontaktit mbështet rekomandimet e sekretarit të përgjithshëm të paraqitura para Këshillit të Sigurimit të bazuara në këtë raport për të nisur procesin e përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit. Grupi mirëpret qëllimin e sekretarit të përgjithshëm për caktimin e një emisari special, i cili do ta udhëhiqte këtë proces. Grupi i Kontaktit me kënaqësi do të mbështesë përpjekjet e emisarit special dhe ekipin e tij. Një zgjidhje negociuese duhet të jetë një prioritet ndërkombëtar. Procesi i filluar nuk mund të bllokohet, por duhet të përfundojë. Grupi

i Kontaktit thërret palët që të angazhohen me besnikëri dhe në mënyrë konstruktive, që të përmbahen nga hapat e njëanshëm dhe të refuzojnë çdo formë të dhunës. Ata të cilët e përkrahin dhunën nuk do të kenë asnjë rol. Emisari special mund të ndër marrë veprime të duhura në kuadër të mandatit të tij në Kombet e Bashkuara për të suspenduar apo përjashtuar çdo individ apo grup nëse mendon se veprimet e tyre nuk shpiten drejt përparimit.

Grupi i Kontaktit thërret të gjitha palët që të themelojnë ekipet negociuese të unitetit dhe të pajtohen mbi pikëpamjet e përbashkëta.

Procesi duhet të sigurojë pjesëmarrjen efikase të serbëve të Kosovës dhe të qytetarëve, si dhe të komuniteteve të tjera të Kosovës. Fqinjët rajonalë dhe palët e tjera të interesuara doemos duhet të konsultohen.

Përparimi i procesit të statusit do të varet jo vetëm nga niveli i angazhimit të palëve, por edhe nga kushtet në terren. Zbatimi i standardeve të caktuara nga Kombet e Bashkuara duhet të vazhdojë gjatë procesit të statusit dhe ato do të jenë faktor i përcaktimit të përparimit të bërë.

Grupi i Kontaktit riafirmon rëndësinë që lidhet me dialog konstruktiv dhe të qëndrueshëm në të gjitha nivelet mes Beogradit dhe Prishtinës dhe mes komuniteteve të ndryshme në Kosovë. Grupi kërkon nga autoritetet në Beograd që në mënyrë aktive të nxisin serbët e Kosovës për të zënë vendet e tyre në institucionet e Kosovës.

Këshilli i Sigurimit do të mbetet aktivisht i preokupuar me këtë çështje. Vendimi përfundimtar mbi statusin e Kosovës duhet të aprovohet nga Këshilli i Sigurimit. Prandaj, Grupi i Kontaktit informon të gjitha palët e kyçura se rezultati i procesit të statusit duhet të bazohet në parimet në vijim:

1. Vendosja e çështjes së Kosovës duhet të jetë plotësisht në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, demokracisë dhe të drejtës ndërkombëtare dhe duhet të kontribuojë në sigurinë e rajonit.

2. Zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të jetë në përputhje me vlerat demokratike dhe standardet evropiane dhe duhet të kontribuojë në realizimin e një Kosove me perspektivë evropiane, në veçanti në përparimin e Kosovës në procesin e stabilizim-asocimit, si dhe integrimin e rajonit të gjithëmbarshtëm në institucionet euroatlantike.

3. Zgjidhja duhet të sigurojë shumetnicitet të qëndrueshëm në Kosovë. Duhet të ofrojë garancinë efikase kushtetuese dhe mekanizma

të përshtatshëm për të siguruar zbatimin e të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët në Kosovë, dhe të drejtat e anëtarëve të të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë të drejtat e refugjatëve dhe të personave të zhvendosur për t'u kthyer të sigurt në shtëpitë e tyre.

4. Zgjidhja duhet të ofrojë mekanizma për sigurimin e pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve kosovare në qeverisje, të nivelit qendror dhe lokal.

5. Zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të përfshijë kujdesin specifik të sigurimit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe religjioze në Kosovë. Kjo duhet të përfshijë cilësimin e statusit të institucioneve të Kishës Ortodokse serbe, vendndodhjeve dhe pronës në Kosovë.

6. Zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të konsolidojë sigurinë dhe stabilitetin rajonal. Në këtë mënyrë, kjo do të sigurojë që Kosova të mos kthehet në gjendjen e para marsit të vitit 1999. Çdo zgjidhje që është e njëanshme apo është rezultat i përdorimit të forcës nuk do të jetë e pranueshme. Nuk do të ketë ndryshime të territorit të tanishëm të Kosovës, që do të thotë nuk do të ketë ndarje të Kosovës dhe bashkim të Kosovës me ndonjë shtet tjetër apo me ndonjë pjesë të ndonjë shteti tjetër. Integriteti territorial dhe stabiliteti i brendshëm i fqinjëve rajonal do të respektohet plotësisht.

7. Zgjidhja e statusit do t'i sigurojë Kosovës siguri. Kjo do të sigurojë gjithashtu që Kosova të mos paraqesë kërcënim ushtarak apo kërcënim të sigurisë për fqinjët e saj.

8. Zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të avancojë mekanizma efikas për të konsoliduar mundësitë e Kosovës për të zbatuar sundimin e ligjit, për të luftuar krimin e organizuar dhe terrorizmin dhe për të mbrojtur karakterin shumetnik të policisë dhe gjyqësorit.

9. Zgjidhja duhet të sigurojë se Kosova mund të zhvillohet në një mënyrë të qëndrueshme ekonomikisht edhe politikisht, dhe se ajo mund të bashkëpunojë në mënyrë efikase me organizatat ndërkombëtare dhe me institucionet ndërkombëtare financiare.

10. Për një kohë Kosova do të vazhdojë të ketë nevojë për një prani ndërkombëtare civile dhe ushtarake për të ushtruar mbikëqyrjen e duhur të përputhshmërisë së kushteve të parapara në zgjidhjen e statusit për ofrimin e sigurisë dhe, në veçanti, për të siguruar mbrojtjen e minoriteteve, si dhe të vëzhgojë dhe të mbështesë autoritetet në zbatimin e vazhdueshëm të standardeve.

### **Aneksi 3:**

Deklarata e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së për periudhën e re të angazhimeve në Kosovë

Grupi i Kontaktit më ka informuar për angazhimin që ka rreth modaliteteve për negociata shtesë ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Kjo përpjekje do të drejtohet nga Treshja, e cila do të përbëhet nga përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, Federatës Ruse dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

E përshëndes këtë nismë nga Grupi i Kontaktit, shpresoj se periudha e re e angazhimit do të çojë në një marrëveshje për statusin e ardhshëm të Kosovës, çështje kjo e cila mbetet prioritet për Kombet e Bashkuara.

Bashkësia ndërkombëtare duhet të gjejë një zgjidhje e cila është (e arritshme) në kohë, i adreson brengat kryesore të të gjitha bashkësive që jetojnë në Kosovë dhe sjell qartësi për statusin e Kosovës. Status quoja nuk është e qëndrueshme.

Zyra e Emisarit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara për Kosovën (UNOSEK) do të jetë e lidhur me këtë proces, duke qëndruar gati për të dhënë informatat dhe sqarimet e nevojshme.

OKB-ja do të vazhdojë të luajë një rol konstruktiv në periudhën e re të angazhimeve dhe po ashtu do të vazhdojë rolin në punën e saj primare në terren në Kosovë.

Grupi i Kontaktit do të më raportojë mua deri më 10 dhjetor.

New York, 1 gusht 2007

#### **Aneksi 4 :**

##### **Ngjarjet e Treshes**

- 09 Gusht - Takimi i parë i Treshes me Grupin e Kontaktit (Londër)
- 10-12 Gusht - Takimi i parë i Treshes me palët (Beograd dhe Prishtinë)
- 30 Gusht - Takimi i dytë i Treshes me palë (Vjenë)
- 18-19 Shtator - Takimi i tretë i Treshes me palët (Londër)
- 27 Shtator - Takimi i Treshes me sekretarin e përgjithshëm të OKB-së, përfaqësuesin e partë të BE-së, sekretarin e përgjithshëm të NATO-s dhe ministrat e Grupit të Kontaktit (New York)
- 28 Shtator - Takimi i katërt i Treshes me palët - takimi i parë i drejtpërdrejtë (New York)



- 14 Tetor – Takimi i pestë i Treshes me palët - takimi i dytë i drejtpërdrejtë (Bruksel)
- 22 Tetor - Takimi i gjashtë i Treshes me palët - takimi i tretë i drejtpërdrejtë (Vjenë)
- 5 Nëntor - Takimi i shtatë i Treshes me palët - takimi i katërt i drejtpërdrejtë (Vjenë)
- 20 Nëntor - Takimi i tetë i Treshes me palët - takimi i pestë i drejtpërdrejtë (Bruksel)
- 26/27/28 Nëntor - Takimi i nëntë i Treshes me palët - takimi i gjashtë i drejtpërdrejtë (Baden, Austri)
- 3 Dhjetor - Takimi i dhjetë i Treshes me palët (Beograd dhe Prishtinë)

### **Aneksi 5:**

#### **Deklarata për Kosovën e ministrave të Grupit të Kontaktit New York, 27 shtator 2007**

Ministrat e Grupit të Kontaktit, bashkë me sekretarin e përgjithshëm të OKB-së, përfaqësuesin e lartë të BE-së, Presidencën e BE-së, komisarin evropian për Zgjerim, dhe sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, janë takuar në New York, më 27 shtator, për të diskutuar për procesin statusor të Kosovës. Ata kanë dëgjuar raportin e Treshes BE-Rusi-SHBA. Një përfaqësues i UNOSEK-ut ishte po ashtu i pranishëm.

Ministrat kanë nënvizuar se një zgjidhje e hershme (shpejt) e statusit të Kosovës është thelbësore për stabilitetin dhe sigurinë në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropën në tërësi. Ministrat kanë ripohuar përkushtimin e tyre të prerë për të gjetur një zgjidhje të negociuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Ministrat kanë shprehur vlerësimin e tyre për përpjekjet e vazhdueshme të UNMIK-ut dhe KFOR-it për kontributin e tyre në krijimin e një Kosove shumëkombëshe, paqësore dhe demokratike. Ata kanë vërtetuar në tërësi vlerësimin e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së se status quoja nuk është e qëndrueshme. Kjo çështje ka pasoja të dëmshme për zhvillimin politik, social dhe ekonomik të Kosovës dhe për stabilitetin themelor të rajonit. Andaj, një zgjidhje duhet të gjendet sa më parë pa shtyrje.

Kur janë takuar në New York, në shtator 2006, ministrat e Grupit të Kontaktit kanë inkurajuar emisarin e posaçëm të OKB-së që të përgatisë një propozim gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit.

Propozimi, i cili është parashtruar pas 14 muajve të negociatave, është pranuar nga Prishtina dhe refuzuar nga Beogradi.

Si përpjekje e shtuar për të gjetur një zgjidhje të negociuar, Grupi i Kontaktit ka themeluar Treshen, detyra e së cilës është që të lehtësojë një periudhë të bisedimeve shtesë mes palëve. Procesi i Treshes do të përfundojë me raportimin e Grupit të Kontaktit tek sekretari i përgjithshëm i OKB-së deri më 10 dhjetor.

Ministrat kanë shprehur mbështetjen e tyre për procesin e Treshes dhe kanë përshëndetur ritmin e shpejtë të aktiviteteve dhe atmosferës konstruktive të raundit të parë të bisedimeve. Ministrat kanë ritheksuar pikëpamjen e tyre se Parimet Udhëzuese të Grupit të Kontaktit nga nëntori 2005 do të vazhdojnë të paraqesin kornizën e procesit statusor, i cili është i bazuar në Rezolutën 1244 të KS të OKB-së.

Hapat e ardhshëm në procesin e Treshes do të përfshijnë takime të drejtpërdrejta në mes të palëve në New York, më 28 shtator. Ministrat e Grupit të Kontaktit kanë mirëpritur këtë hap për bisedime të drejtpërdrejta. Ministrat u kanë bërë thirrje të dyja palëve që t'u qasen negociatave të ardhshme me kreativitet, guxim dhe në frymë kompromisi. Gjithashtu, çfarëdo zgjidhjeje duhet të jetë e pajtueshme për popullin e Kosovës, të sigurojë zbatimin e standardeve sa i përket karakterit (të krijimit) të një Kosove shumëkombëshe dhe promovimit të stabilitetit të ardhshëm në rajon. Ministrat kanë nënvizuar se çfarëdo zgjidhjeje e ardhshme duhet të përqendrohet në zhvillimin e një mjedisi special të marrëdhënieve mes të dyja palëve, në veçanti në dimensionet e tyre historike, ekonomike, kulturore dhe njerëzore.

Ministrat u kanë bërë thirrje palëve që të marrin seriozisht shansin e krijuar nga procesi i Treshes për të siguruar një zgjidhje të negociuar. Përgjegjësia është në secilën palë për të zhvilluar propozime realiste. Megjithëse propozimi gjithëpërfshirës i emisarit të posaçëm të OKB-së për Kosovën mbetet në tavolinë, Grupi i Kontaktit është i gatshëm që të përkrahë çfarëdo marrëveshjeje të arritur ndërmjet palëve. Ministrat kanë ripërsëritur orvatjet për një marrëveshje të negociuar se nuk do të paqartësojnë faktin se asnjëra palë nuk mundet njëanshmërisht të bllokojë procesin statusor për të ecur përpara. Ministrat mbështesin angazhimin e vazhduar të OKB-së dhe kanë përshëndetur gatishmërinë e NATO-s dhe të BE-së për të pasur një rol prijës në zbatimin e një marrëveshjeje për statusin e Kosovës dhe për të vazhduar përgatitjet e nevojshme për këtë përgjegjësi. Ministrat

kanë përshëndetur qasjen aktive të adoptuar nga BE-ja në lidhje me perspektivën evropiane të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Ministrat kanë shquar dhe përshëndetur zotimet e dhënë Treshes nga palët se do të shmangen nga fjalët dhe veprimet provokuese, sikur edhe u bëjnë thirrje palëve që t'iu përmbahen këtyre zotimeve. Zhvillimet politike në Kosovë dhe Serbi nuk do të duhet të ndërhyjnë me angazhimin konstruktiv të palëve në procesin e Treshes. Ata kanë shprehur dëshirën e tyre se zgjedhjet, që pritet të mbahen më 17 nëntor në Kosovë, do të ngjajnë me pjesëmarrjen e plotë të të gjitha bashkësive kundruall një mjedisi të qetë dhe të përpiktë.

Të gjithë të pranishmit në këtë takim do të mbesin ngushtë të angazhuar me procesin dhe fuqimisht mbështetës të përpjekjeve të Treshes.

## **Aneksi 6:**

### **Dokumenti jozyrtar i Vjenës (Non-paper)**

Me rastin e takimit me Treshen më 30 Gusht në Vjenë, të dyja palët kanë ripohuar deklaratat e tyre lidhur me situatën e sigurisë.

Delegacioni i Beogradit ka ripohuar gatishmërinë e vet që të bëjë çmos që është në fuqinë e vet për të siguruar paqen dhe stabilitetin gjatë këtij procesi. Pala serbe dhe institucionet e veta do të ushtrojnë vigjilence të posaçme në këtë aspekt.

Delegacioni i Prishtinës ka ripohuar gatishmërinë e vet që të bëjë çmos që është në fuqinë e vet për të siguruar paqen dhe stabilitetin gjatë këtij procesi, marrë parasysh mandatin e KFOR-it për paqen dhe një mjedis të sigurt në Kosovë dhe mandatin përkatës të policisë së UNMIK-ut dhe Shërbimit Policor të Kosovës.

Të dyja palët kanë premtuar se do të përmbahen nga çfarëdo akti apo deklarate e cila do të mund të shihej si provokuese në një atmosferë delikate gjatë periudhës së tashme të angazhimit. Të dyja palët janë pajtuar se këto zotime reciproke duhet të shërbejnë si masa të ndërtimit të mirëbesimit në fillim të periudhës së angazhimit me Treshen.

Ky tekst u është lexuar të dyja delegacioneve më 30 Gusht dhe konfirmuar në praninë e të gjithë anëtarëve të Treshes.

### **Aneksi 7: Deklarata e New York-ut (28 Shtator)**

Në takimin e tyre me Treshen më 28 Shtator në New York, të dyja delegacionet kanë mirëpritur takimin e parë të drejtpërdrejtë mes

palëve nën drejtimin e Treshes. Palët kanë ripohuar përkushtimin e tyre për të angazhuar seriozisht në këto bisedime. Treshja ka përkujtuar palët për deklaratën e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së të 1 gushtit se status quo-ja është e paqëndrueshme.

Të dyja delegacionet janë informuar për deklaratën e Grupit të Kontaktit në takimimin ministror në New York më 27 shtator. Ministrat kanë ripohuar, ndër të tjera, se një zgjidhje e shpejtë e statusit të Kosovës është thelbësore për stabilitetin dhe sigurinë në Ballkanin Perëndimor dhe Evropën në tërësi. Ministrat kanë ritheksuar përkushtimin e tyre për të kërkuar një marrëveshje të negociuar që do të vërtetohej nga KS i OKB-së. Parimet udhëzuese të Grupit të Kontaktit do të vazhdojnë të përbëjnë kornizën e procesit statusor, të bazuar në Rezolutën 1244 të KS të OKB-së. Ministrat po ashtu u kanë bërë thirrje të dy anëve që t'i qasen kohës së mbetur gjatë negociatave me kreativitet, guxim dhe në frymë kompromisi. Ata u kanë bërë thirrje palëve që të marrin seriozisht shansin e krijuar nga procesi i Treshes për të siguruar një zgjidhje të negociuar. Ata kanë përkujtuar palët se përgjegjësia është në secilën palë për të zhvilluar propozime realiste, dhe se asnjëra palë nuk mundet njëanshmërisht të bllokojë procesin për të ecur tutje. Ministrat kanë nënvizuar se çfarëdo zgjidhje e ardhshme për statusin duhet të përqendrohet në krijimin e një mjedisi të posaçëm të marrëdhënieve mes të dy palëve, veçanërisht në dimensionet e tyre historike, ekonomike, kulturore dhe humane.

Duke vërtetuar se dhuna, provokimet dhe kërcënimet do të përbëjnë një rrezik madhor për procesin e Treshes sikur edhe për stabilitetin dhe sigurinë në rajon, të dyja palët kanë ripohuar përkushtimin e tyre, sikur që është theksuar në dokumentin e Vjenës të 30 gushtit, për t'u përmbajtur nga çfarëdo aktiviteti apo deklarate e cila do të mund të rrezikojë situatë e sigurisë.

Të dyja palët kuptojnë se Grupi i Kontaktit do t'i raportojë sekretarit të përgjithshëm të OKB-së deri më 10 dhjetor 2007. Në këtë aspekt, ata mirëpresin synimin e Treshes që të intensifikojë programin e vet të punës në saje të arritjes së një marrëveshjeje përpara se mandati i Treshes të përfundojë.

Është pranuar nga të dyja delegacionet në takimimin e parë të drejtpërdrejtë në New York më 28 shtator dhe konfirmuar në praninë e të gjithë anëtarëve të Treshes.

## **Aneksi 8:**

## **Vlerësimet e Treshes për negociatat:**

### **Konkluzionet parimore**

Treshja ka rishikuar pozitat e të dyja palëve. Pa paragjykime për pozitat e të dyja palëve për statusin, parimet vijuese mund të hapin rrugën për një zgjidhje:

1. Beogradi dhe Prishtina do të përqendrohen në zhvillimin e një mjedisi të posaçëm të marrëdhënieve ekzistuese ndërmjet tyre, veçanërisht në dimensionin historik, ekonomik kulturor dhe human (njerëzor);

2. Beogradi dhe Prishtina do të zgjidhin problemet e ardhshme ndërmjet tyre në mënyrë paqësore dhe nuk do të angazhohen në veprime apo dispozita të cilat do të mund të shihen si kërcënuese për palën tjetër;

3. Kosova do të jetë tërësisht e integruar në strukturat rajonale, veçanërisht ato që përfshijnë bashkëpunimin ekonomik;

4. Nuk do të ketë kthim në statusin para vitit 1999;

5. Beogradi nuk do të qeverisë Kosovën;

6. Beogradi nuk do të ri-ngrejë praninë fizike në Kosovë;

7. Beogradi dhe Prishtina janë të vendosur që të bëjnë përparime drejt asocimit dhe anëtarësimit eventual në BE, sikur edhe do të ecin me hapa përparimtarë drejt strukturave euroatlantike;

8. Prishtina do të zbatojë masa të gjëra për të shtuar mirëqenien e serbëve kosovarë sikur edhe të bashkësive të tjera jo-shqiptare, në veçanti përmes decentralizimit të pushtetit lokal, garancive kushtetuese dhe mbrojtjes e trashëgimisë kulturore dhe fetare;

9. Beogradi dhe Prishtina do të bashkëpunojnë në çështje të interesit reciprok, përfshirë:

a) Fatin e personave të pagjetur dhe kthimit të të zhvendosurve,

b) Mbrojtjes së pakicave,

c) Mbrojtjes së trashëgimisë kulturore,

d) Perspektivës së tyre evropiane dhe nismave rajonale,

e) Çështjeve ekonomike, përfshirë politikën fiskale dhe energjinë, tregtinë dhe harmonizimin me standardet evropiane dhe ndërtimin i një strategjie të zhvillimit të përbashkët ekonomik në përputhje me nismat rajonale ekonomike,

f) Lirisë së lëvizjes së njerëzve, të mirave, kapitalit dhe shërbimeve,

g) Sektorin bankar,

- h) Infrastrukturën, transportin dhe komunikimin,
  - i) Mbrojtjen e mjedisit,
  - j) Shëndetit publik dhe mirëqenies sociale,
  - k) Luftës kundër krimit, në veçanti në fushat e terrorizmit, trafikimit njerëzor, të narkotikëve, armëve dhe krimit të organizuar.
  - l) Bashkëpunimin ndërmjet komunave dhe Qeverisë të njërës nga të dyja anët,
  - m) Arsimin,
10. Beogradi dhe Prishtina do të themelojnë trupa të përbashkët për të zbatuar bashkëpunimin,
11. Beogradi nuk do të ndërhyjë në marrëdhëniet e Prishtinës me Institucionet Ndërkombëtare Financiare,
12. Prishtina do të ketë autoritetin e plotë kundruall financave të veta (taksat, të ardhurat publike etj.),
13. Procesi i Stabilizim Asociimit i Kosovës me BE-në (Mekanizmi Përcjellës) do të vazhdojë i papenguar nga Beogradi,
14. Bashkësia ndërkombëtare do të mbajë prani civile dhe ushtarake në Kosovë pas përcaktimit të statusit.

## **Aneksi 9:**

### **Deklarata për shtyp e Trojkës: Konferenca e Badenit Baden, Austri, 28 nëntor 2007**

Trojka ndërmjetësuese BE/SHBA/Rusi e ka përmbyllur një konferencë intensive me delegacionet nga Beogradi dhe Prishtina për të diskutuar statusin e Kosovës. Trojka ka sjellë bashkë liderët e të dyja palëve në Baden, Austri, për gati tri ditë të bisedimeve të thella. Konferenca e Badenit shënon fundin e negociatave ballë për ballë të organizuara nga Trojka.

Gjatë rrjedhës së bisedimeve, Trojka u ka bërë thirrje palëve që të shqyrtojnë një linjë të gjerë opsionesh për statusin e Kosovës. Trojka ka hulumtuar bashkë me të dyja palët çdo rezultat të arsyeshëm të statusit për Kosovën që të përcaktojë se ku mund të jetë potenciali për një rezultat të pranueshëm nga të dyja palët.

Për keqardhje, palët nuk ishin në gjendje të arrinin një marrëveshje për statusin e ardhshëm të Kosovës. Megjithatë, Trojka beson se palët kanë përfituar nga kjo periudhë intensive e dialogut. Ky ishte një rast për ato që të ndërtojnë besimin dhe të identifikojnë interesat e

përbashkëta, posaçërisht dëshirën e tyre që të kërkojnë një të ardhme më të mirë përmes arritjes së perspektivës evropiane.

Negociatat e udhëhequra nga Trojka u kanë ofruar palëve gjashtë raste për të diskutuar drejtpërdrejt statusin final të Kosovës. Negociatat kanë krijuar një mundësi për t'u përfshirë në dialog në nivelin më të lartë. Këto takime kanë lejuar Trojkën që të ritheksojë rëndësinë e mbajtjes së paqes, duke iu shmangur nxitjes së dhunës dhe rrezikimit të sigurisë në rajon. Palët i kanë pranuar këto parime vazhdimisht, së fundi gjatë Konferencës së Badenit. Të dy palët e kanë bërë të qartë se ato duan t'i shmangen dhunës. Ky përkushtim për paqe duhet të vazhdojë edhe pasi që Trojka të komplotojë punën e vet më 10 dhjetor. Trojka u bën thirrje Beogradit dhe Prishtinës që të mbajnë komunikimet pa paragjykim për pozicionet e tyre në lidhje me statusin. I mbetet Beogradit dhe Prishtinës që të mbajnë përkushtimin e tyre ndaj paqes dhe dialogut rreth çështjeve me interes të përbashkët. Trojka tani do të nisë hartimin e raportit që do t'i dorëzohet jo më vonë se më 10 dhjetor sekretarit të përgjithshëm nga Grupi i Kontaktit. Gjatë vizitës që Trojka do t'u bëjë më 3 dhjetor Beogradit dhe Prishtinës, ajo do të rishikojë raportin me palët. Pasi Grupi i Kontaktit ta dorëzojë raportin tek sekretari i përgjithshëm i OKB-së, mandati i Trojkës do të përfundojë.

*4 dhjetor 2007*

**Përgatiti për botim, kryeredaktori i pashtriku.org, Sheradin Berisha.**

~~~~~

© Pashtriku.org, dhjetor 2007